



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 5005 prot.
|
2

Tiranë, më 9 / 11 / 2020

URDHËR

Nr. 616, datë 9 . 11 . 2020

“PËR

KUFIZIMIN E LËVIZJES BRENDIA VENDIT”

Në mbështetje, të nenit 7, pika 4, gërmat “d” të Ligjit Nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, sipas udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, në zbatim të Vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr.5005, datë 09.11.2020, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Kufizimin e lëvizjes së popullatës nga ora 22:00 deri në orën 06:00, në të gjithë vendin, deri në datën 02.12.2020.
2. Përjashtim nga rregulli i përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhëri bëhet për personat që duhet të lëvizin për emergjenca shëndetësore, motive pune apo nevoja të domosdoshme. Personat që lëvizin për arsye pune apo arsye të domosdoshme pajisen me autorizimin përmes portalit e-Albania.
3. Personeli i shëndetësisë, punonjësit e strukturave të shërbimeve kritike, përjashtohen nga rregulli i aplikimit në portalin e-Albania, duke patur dokumentacionin që vërteton punësimin pranë institucioneve.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri organet kompetente për dhënien e masave administrative sipas Aktit Normativ nr. 3 datë 15.03.2020 “Për marrjen e masave të vecanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së shkaktuar nga Covid-19”, i ndryshuar.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe fillon efektet më datë 11.11.2020.

MINISTRI
Ogerta Manastirliu



